



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/74

Datë: 14.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin e përcaktuar në pikën 1. të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/74

Datë: 14.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2009, mori

V E N D I M

1. I lejohet Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të nënshkruajë Udhëzimin Administrativ për Lirimet nga Detyrimet Doganore.
2. Obligohet Zyra Ligjore e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që Udhëzimin Administrativ nga pika 1. e këtij vendimi ta përgatisë për nënshkrim nga Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/74

Datë: 14.07.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2009, mori

V E N D I M


1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të autoritetit të saj sipas nenit 3.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe me qëllim të përmbushjes së synimeve të këtij ligji, duke filluar menjëherë, vendos:
 - 1.1 Të gjitha ndërmarrjet e themeluara nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit për mbajtjen e aksioneve dhe/ose interesave pronësore në një NP tjetër, janë NP qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës dhe i nënshtrohen Ligjit për Ndërmarrjet Publike (në tekstin e mëtejshëm "NP Ndërmarrje Holding");
 - 1.2 Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP menjëherë do të përgatisë listën për identifikimin e të gjitha NP Ndërmarrjeve Holding dhe t'ia dorëzojë të njëjtën Qeverisë;
 - 1.3 Në cilësinë e ushtruesit të të drejtave pronësore dhe të aksionarit të Republikës së Kosovës në këto NP Ndërmarrje Holding, të drejta këto të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ministri i Ekonomisë dhe Financave ("Ministri") autorizohet dhe urdhërohet të veprojë në emër të Qeverisë dhe Republikës së Kosovës, si pronare e vetme e ligjshme e aksioneve në NP Ndërmarrjet Holding dhe të marrë gjitha masat e ligjshme dhe të nevojshme për bartjen e të gjitha aksioneve në NP, të cilat mbahen nga këto NP Ndërmarrje Holding në Republikën e Kosovës, dhe pas kësaj t'i shpërbëjë këto NP Ndërmarrje Qendrore Holding. Nën-paragraf 1.3 nuk i

cenon veprimet specifike të cilat kërkohen nga paragrafi 2 që ka të bëjë me aksionet dhe listat e aksionarëve të PTK-së.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të të drejtave pronësore dhe të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A" ("PTK"), të drejta këto të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, autorizon dhe urdhëron Ministrin e Ekonomisë dhe Financave ("Ministri") të veprojë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si pronarja e vetme e ligjshme e aksioneve në PTK, si dhe të ushtrrojë, në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe të ligjshëm, të gjitha të drejtat e ligjshme të aksionarit për realizimin e veprimeve në vijim:
 - 2.1 Të sigurojë që PTK të zbatojë nenin 3.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
 - 2.1.1 Ndryshon listën e saj të aksionarëve për të pasqyruar Republikën e Kosovës si aksionarin e vetëm të PTK-së.
 - 2.1.2 Anulon të gjitha aksionet e emetuara paraprakisht nga PTK cilëso NP Ndërmarrje Holding ose cilitdo person ose organizatë tjetër.
 - 2.2 Të ndryshojë statutin e PTK me qëllim të reduktimit të kapitalit themeltar të PTK në pesë milionë euro (5.000.000 euro) të përbërë nga pesë milionë (5.000.000) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej një (1) euro secili.
 - 2.3 Të kërkojë nga PTK që të nxjerrë certifikata të aksioneve për të gjitha aksionet në emër të Republikës së Kosovës, dhe që t'ia dorëzojë të njëjtat Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, e cila vepron në cilësinë e kujdestarit të këtyre certifikatave në përputhje me nenin 4.4 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
 - 2.4 Të sigurojë që, në ditën e parë të punës pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve të përcaktuara në nën-paragrafin 2.2 më lartë, PTK të deklarojë dhe t'i paguajë Republikës së Kosovës një dividendë në shumën prej dyqind milionë (200.000.000) euro ("dividendi i vitit 2009").
 - 2.5 Të sigurojë që PTK të mos ndërmarrë asnjë veprim ose të kryejë ndonjë transaksion, pavarësisht nëse është paraparë në planin e saj të biznesit, para pagimit të dividendit të vitit 2009, i cili do të ndikonte materialisht në aftësinë e PTK-së për deklarimin dhe pagimin e shumës së plotë të dividendit për vitin 2009.
 - 2.6 Të sigurojë që PTK menjëherë të ndryshojë planin e saj të biznesit sipas nevojës, për të pasqyruar pagesën e dividendit për vitin 2009.
 - 2.7 Të sigurojë që PTK të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për mbajtjen e librave, shënimeve, listave dhe regjistrave të

korporatës dhe të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe të sigurojë që PTK t'i shënojë dhe regjistrojë të gjitha veprimet e lartpërmendura në këto libra, regjistra, lista dhe shënime.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë